



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V_280_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_428_06_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_428_06_10** ;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 26.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Veton Hoxha (shifra e konsumatorit DPR – 31766) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 27.03.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 24.03.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Në periudhën 03/2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 17669983 dhe ka vendosur për matje njehsorin nr. 40863113

Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 003423

- Me datë 22.10.2008 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 17669983, ku është konstatuar se njehsorit elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka të falsifikuara, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, numëruesi nuk është i vendosur mirë në vendin e vet. Numëruesi i njehsorit është i manipuluar, ka gjurmë të kthimit mbrapa të numrave në numëror.
Provë: Procesverbali me nr. 210/22i datës 22.10.2008
- Me datë 17.12.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 208631 të datës 17.12.2008
- Me datë 05.02.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR09HP07276 në vlerë prej 1,951.31€.
Provë: Fatura DPR09HP07276 e datës 05.02.2009
- Me datë 19.02.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 24.03.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 24.03.2009
- Me datë 27.03.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_ 428_06_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

